

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E HËNË 31 TETOR 2022

Zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Po e lëvizim debatin për ndarjen territoriale-administrative në sferën e absurdes. U mor vendimi për ngritjen e Komisionit ad hoc për Reformën Territoriale-Administrative, në një kohë kur maxhoranca me përfaqësuesin e saj zyrtar parlamentar deklaronte se nuk kishte ndër mend të ndërmernte asnjë lloj nisme për ndryshimin e numrit të bashkive, as edhe për ndryshimin e kuadrit ligjor, mbi të cilin funksionon pushteti vendor.

Pyetja e shtruar prej meje që ditën e konstituimit të komisionit të posaçëm drejtuar kolegëve të maxhorancës ishte: a keni mandat realisht të negociojmë dhe të konkludojmë në diçka konstruktive, që do të jetë produkt i procesit që do të ndjekim në komision? Na u tha se kishin mandat të plotë. U përsëritën deklaratat e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste se nuk kishin ndër mend që të merreshin me reformën territoriale-administrative. Sot në seancën plenare provohet se kjo nuk ishte lëvizje taktike, por ishte strategjia e maxhorancës. Pse, zotërinj, nuk na e kursyet si individualisht, ashtu edhe institucionalisht këtë kosto? Nuk jemi ndonjë parlament që ka ndonjë kredibilitet në shoqëri dhe te qytetarët. E dini fort mire, e ndieni në kontaktin që keni me ta se sa të zhvlerësuar jemi, e theksoj sërish, individualisht dhe si institucion. Në një kohë kur duhet të reflektojmë dhe të ndryshojmë, ne vazhdojmë të thellojmë mentalitetin dhe praktikën, të cilat na kanë çuar pikërisht në këtë situatë. Kjo është e para.

Së dyti, flitet për pushtetin vendor, por nuk flitet për thelbin e tij, për përfaqësimin e qytetarëve. Demokracia nuk fillon dhe mbaron me ditën e zgjedhjeve, pra zgjedhim një kryetar, një këshill dhe mbaroi i gjithë procesi demokratik për të gjithë 4-vjeçarin, por është një proces i përditshëm, ku qytetari shprehet, propozon dhe pret vendimmarrje. Pavarësisht se ju mund të panegjirizoheni me të famshmin dhe të magjishmin numrin 61, reforma ka dështuar për përfaqësimin e qytetarëve. Sot qytetarët e kanë më të lehtë që të takojnë deputetët dhe një çështje e tyre të ngrihet në parlamentin e Republikës se, për shembull, në Bashkinë e Tiranës, ku ka jo vetëm komunitete, por ka edhe ish-njësi administrative që nuk kanë as edhe një përfaqësues të vetëm në këshillin bashkiak. Si do të ndodhë përfaqësimi i tyre? Si do të

merren shërbimet që ata kërkojnë, në një kohë kur edhe kontakti fizik pothuajse është i pamundur gjatë gjithë mandatit?

Zonja dhe zotërinj, flasim të gjithë për fenomenin e shpopullimit. E dini se cilat zona janë dëmtuar më shumë në marrjen e shërbimeve gjatë këtyre dy mandateve me këtë ndarje të re administrative? Janë pikërisht ato zona që vuajnë nga shpopullimi. Nuk ka fetishizim numrash. Çfarë është pushteti vendor dhe cili është synimi? T'i ofrojë shërbimet një demografie të caktuar në një gjeografi të caktuar. Mund të ketë bashki me 400 mijë banorë dhe t'u shërbehet për mrekulli në gjeografinë ku është shtrirë, por mund të ketë bashki me 5 apo 6 mijë banorë, ku nuk mund t'u ofrohen shërbime me të njëjtat standarde, për shkak se jetojnë në një gjeografi të ndryshme, më të vështirë për nga kushtet objektive. Atëherë, a ekziston vullneti që të ulemi dhe t'i shikojmë?

Unë mund t'ju them se ka pasur bashki, nga këto 61, që janë përjashtime, ku u përmirësua ofrimi i shërbimeve. Po, por janë përjashtime, sepse në shumicën dërmuese të tyre janë dëmtuar. Ju lutem, dëgjoni rastin e një bashki, që është bashkia e skajshme e Leskoviku. Që ta marrë banori i Leskovikut sot shërbimin në Bashkisë e Ersekës, duhet të bëjë 100 kilometra vajtje-ardhje për të shkuar në qendrën e bashkisë dhe me ato rrugë që ju i dini se si janë; në qoftë se nuk i dini, mund t'i fantazoni. Mund të shkojë shumë më lehtë në qytetin e vendit fqinj, në Konicë, se sa në Ersekë, në një kohë kur i ka të gjitha resurset natyrore, ka histori, ka trashëgimi, por askush nuk mendon. Fetishizimi i numrit 61 është në shërbim të interesit të vogël partiak, Keni bërë 61 feude. Ky është mentaliteti juaj feudal dhe keni bërë feude, sepse nuk mund të funksiononi ndryshe.

Prandaj, zonja dhe zotërinj, unë dua të theksoj le t'i paraprijmë një herë që të tregohemi realisht se jemi të sinqertë në atë që pohojmë se jemi europianë dhe na takon të jemi në familjen europiane. Le ta shohim ne problemin, sepse do t'i rikthehem ndarjes territoriale administrative, do të fillojnë negociimet me Bashkimin Europian, kapitull për kapitull, do ta kërcejmë vallen, sepse sazeve do t'u bjerë Brukseli, por pse nuk e bëjmë tani, kur i kemi të gjitha mundësitë që të kemi një ndarje të re, një ndarje funksionale, një ndarje në të cilën qytetari do të ndihet i përfaqësuar, do të dëgjohet dhe do të arrijë të marrë shërbime, për të cilat ka nevojë sot?!

Kudo flitet për zhvillimin e agroturizmit. Ju e dini se sa zona të mrekullueshme dhe të bekuara kemi nga perëndia, me resurse e mrekulli natyrore, por që ne kemi bërë të pamundurën e vazhdojmë ta bëjmë që këto të shpopullohen dhe, duke u shpopulluar, natyrisht, lëmë të pashfrytëzuara edhe këto resurse, edhe potencialin e tyre ekonomik. Prandaj, zonja dhe zotërinj të maxhorancës, mos na fusni të gjithëve

në atë lojën e maces që ndjek bishtin e vet pa arritur ta kapë asnjëherë, mos kujtoni se mund ta mbani peng për një kohë edhe më të gjatë një shoqëri, komunitetet dhe qytetarët, duke i privuar nga zhvillimi dhe prosperiteti për interesat e qeverisjes suaj, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse interesat tuaja dhe të klientëve tuaj. Kjo është një lojë që mund të zgjasë për pak, por nuk mund ta zgjasni në pafundësi. Ju faleminderit!